



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 03.08.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Pastrim dhe Riparime të Sistemit të Kanalizimeve të Ujërave të Shiut”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime në kanalizime 45232410-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

58,310,817.12 (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e dhjetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pikë dymbëdhjetë) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës 2026-2028.

Argumentimi:

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.284, datë 13/07/2026, me Nr.9738 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit, dokumentet sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondin limit, shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuara nga grupi i punës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.284, datë 13/07/2026, me Nr.9738 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në VKM nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 58,310,817.12 (*pesëdhjetë e tetë milion e treqind e dhjetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pikë dymbëdhjetë*) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 5 (*pesë*) muaj, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, *sipas Shtojcës 3*;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas shtojcës 8*.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Pastrim dhe Riparime të Sistemit të Kanalizimeve të Ujërave të Shiut”. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar

flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së Pastrim dhe Riparime të Sistemit të Kanalizimeve të Ujërave të Shiut, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare 2023, 2024, 2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteri është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpallje së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin*

e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumn e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

Për sa i përket kapaciteteve të tjera teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.284, datë 13/07/2026, me Nr.9738 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP.1A	Punime gjurmimi në tokë;
NP.4A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP.7A	Ujsjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
NP.12A	Punime të inxhinierisë mjedisore
NS.1A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS.15A	Pastrim i ujrave detar m liqenor dhe lumore
NS.18A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të

Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë e respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 Punime gërmimi në tokë.	Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet Pastrim pusete shimblethesi me makeniri Pastrim kolektori Ø500mm deri Ø2500 mm me autobot teknologjik dhe makineri ndihmëse Pastrim kolektori Ø200 mm deri Ø500 mm me autobot teknologjik dhe makineri ndihmëse Pastrim pusete me makineri	NP-1 A	19,996,149 leke

NP-4	Rruge , Autostrada , mbikalime , hekurudha tramvai, metro, pista aeroportuale	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 10cm, me makineri Shtrese betoni C20/25 Prishje shtresa betoni Prerje asfalti me disk, ne te dy anet. Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize F.V. Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Shtresë çakëlli Shtrese stabilizant t=10cm		2,106,655 leke
NP-7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërrhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, fungsionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.	Inspektim i kolektorëve me diametër (500÷2500) mm me sisteme kamerash CCTV Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize F.V. Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Shtresë çakëlli Shtrese stabilizant t=10cm Riprim pusete ekzistuese kontrolli Riprim pusete ekzistuese shiu F.v Pusete kapeshe shiu Tipi 1 Riprim pusete ekzistuese komandimit (Penstock)	NP-7 A	11,338,934 leke
NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime të veprave dhe punimeve të veçanta ose	Transport i llumit, dheut me auto mbi 10.0 km, Transport materiale	NP-12 A	1,535,444 leke

	të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.	ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km		
NS-1 Punime prishjen ndërtimeve.	Punime për prishjen e ndërtimeve Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.	Skarifikim shtrese asfalti me makineri, Prishje shtresa betoni.	NS-1 A	19,000 leke
NS15 Pastrim i ujerave detar m liqenor dh lumore	Pastrim i ujerave detar m liqenor dh lumore	Pastrim kolektori Ø500mm deri Ø2500 mm me autobot teknologjik dhe makineri ndihmëse Pastrim kolektori Ø200 mm deri Ø500 mm me autobot teknologjik dhe makineri ndihmëse	NS15-A	19,944,866
NS18	Punime topogjeodezike	Punime matje topografike	NS18-A	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Mjedisi profili Trajtim ujerash 1(një)

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për personelin kryesor, drejtues teknik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Inxhinier Mjedisi, profili “trajtim ujrash” kërkohet për shkak të natyrës së veçantë të objektit, i cili përfshin ndërhyrje të drejtpërdrejta në sistemin e kanalizimeve dhe kolektorëve të ujërave të shiut, duke përfshirë pastrimin e kolektorëve me diametra të mëdhenj, pastrimin e pusetave, transportin e llumit dhe materialeve të nxjerra nga sistemi, si dhe riparimin e elementeve të rrjetit të drenazhimit. Preventivi parashikon pastrimin e kolektorëve me diametër Ø500–Ø2500 mm në një volum prej 3,027 m³, pastrimin e pusetave dhe transportin e 1,130.1 m³ llum dhe, çka kërkon administrim dhe mbikëqyrje të specializuar të materialeve të nxjerra nga sistemet ujore dhe të ndikimit të punimeve në sistemin e ujërave. Prania e një inxhinieri mjedisi me profil “trajtim ujrash” si drejtues teknik lidhet drejtpërdrejt me nevojën për mbikëqyrjen profesionale të proceseve të pastrimit të rrjetit, menaxhimit të materialeve të nxjerra dhe garantimit të kryerjes së punimeve në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore.. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë

përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- b. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- c. Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- d. Inxhinier Elektrik 1 (një)
- e. (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune të vlefshme, diplomë (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në përlogaritjen e oreve të punës, kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmërinë e realizimit sa më shpejt të objektit.

- ***Inxhinieri Gjeodet*** është kërkuar me qëllim realizimin e rëlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.
- ***Inxhinieri i Elektrik*** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektrike të parashikuara në projekt si montimi i AUMA.
- ***Inxhinieri i Ndërtimit*** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit, stabiliznatit. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant si dhe për punimet e hekur betonit.
- ***Inxhinieri i Hidroteknik*** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve si dhe për punimet e shimblethesave dhe pusëve kontrollit.
- ***Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë***, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këto kontrate ku dhe numuri i punojësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Hidraulik	1(një) punonjës
b. Elektricit	1(një) punonjës
c. Saldator	1(një) punonjës
d. Mekanik	1(një) punonjës
e. Karpentier	1(një) punonjës
f. Hekurthyes	1(një) punonjës
g. Betonues	1(një) punonjës
h. Drejtues Mjeti	2 (dy) punonjës
i. Manovratorë	3 (tre) punonjës

Për të gjithë punonjësit e specializuar/të kualifikuar e mësipërm, Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune të vlefshme;
- Diplomë profesionale, certifikatë ose dokument tjetër që provon kualifikimin profesional, lëshuar nga institucione të licencuara sipas legjislacionit në fuqi ose ekuivalente;
- Certifikatë të sigurimit teknik, të lëshuar nga subjekte të akredituara nga DPA ose organizma ekuivalentë ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, kur kërkohet sipas profilit të punës.

Për punonjësit drejtues mjeti duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Leje drejtimi e vlefshme;
- Certifikatë e aftësisë profesionale ose patentë manovrimi e lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur shoferët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për manovratorët duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Dëshmi aftësie profesionale për përdorimin e makinerive të rënda, sipas legjislacionit në fuqi dhe Urdhrit nr.200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Në rastin kur manovratorët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për punëtorët e kualifikuar duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre*

punimeve sipas standardeve te përcaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, ne mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne katër elementet e strukturës së kostos(material,punëtore, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- **Karpentieret dhe hekurthyesit dhe betonues** janë të nevojshëm për punimet e armaturave të hekurit dhe betonit .
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda si eskavatori, rruli, autovinc etj
- **Drejtuesit e mjetit** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere.
- **Hidraulikët** janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e sistemeve të kanalizimit të ujërave të ndotura, përfshirë montimin e tubacioneve, kontrollin e pompave, dhe sigurinë e rrjedhës së ujit.
- **Elektricitist** është i nevojshëm për të garantuar instalimin e portës së komandimit AUMA.
- **Mekaniku dhe saldatori** janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e portës së komandimit penstock.
- **Punëtorët e kualifikuar të ndërtimit** janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin dhe pastrimin e rrjetit të kanalizimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 28 (njëzet e tetë) persona, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.
- c. Në rastin kur drejtuesit e mjetit dhe manovratorët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Numri prej 28 punonjës përfshin 10 punëtorë të thjeshtë + 18 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, manovratorë dhe hidraulikë përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marre parasys kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 28 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë,

kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar ne katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1.	Autobote për transport uji të pajisur me pompe presioni kapacitet 9000 – 15000 Litra	Pronësi ose me qira	3 copë
2.	Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo më pak se 2 ton, e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo më pak se 150 bar, prurje jo më pak se 100 litra/minut	Pronësi ose me qira	1 copë
3.	Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo më pak se 9 ton, e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo më pak se 270 bar, prurje jo më pak se 330 litra/minuta	Pronësi ose me qira	1 copë
4.	Pajisje hidraulike me peshe jo më pak se 400 kg dhe presion pune jo më pak se 630 bar, për ruajtjen e stabilitetit të kolektoreve të KUZ dhe KUSH me diametër deri në 1.5 m.	Pronësi ose me qira	1 copë
5.	Automjet teknologjik për pastrimin e pusëve të kolektoreve të KUZ dhe KUSH dhe pusëve të shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo më pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike për ngarkimin e materialeve të ngurta dhe vërc me kapacitet ngrites jo më pak se 0.3 ton.	Pronësi ose me qira	1 copë
6.	Automjet teknologjik i pajisur me kamera CCTV për kontrollin e brendshëm të tubacioneve	Pronësi ose me qira	1 copë
7.	Automjet teknologjik për transport materialit me kazan hermetik kapacitet 4m3	Pronësi ose me qira	2 copë
8.	Makineri autovërc me kapacitet mbajtës 5 ton, me komandim në distancë më 15 m largësi, si dhe i pajisur me organello	Pronësi ose me qira	1 copë

9.	Eskavator me zinxhir 7 deri në 8.5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
10.	Fadrome me goma kove para-mbrapa (mjet teknologjik) 8 deri në 9 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
11.	Mini fadrome (bobcad)	Pronësi ose me qira	1 copë
12.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbartës 10 deri në 18 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
13.	Kamiocine kapacitet 3.5 deri në 5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
14.	Kamionçinë me kapacitet mbartës min 0.5-1.5 ton, për transport të përzier	Pronësi ose me qira	2 copë
15.	Kamion me vinxh me kapacitet mbartës 5 deri në 10 ton	Pronësi ose me qira	2 copë
16.	Freze asfalti	Pronësi ose me qira	1 copë
17.	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	Pronësi ose me qira	1 copë
18.	Motogjenerator 100kë	Pronësi ose me qira	1 copë
19.	Kompresor	Pronësi ose me qira	1 copë
20.	Matrapik	Pronësi ose me qira	1 copë
21.	Saldatrice	Pronësi ose me qira	1 copë
22.	Vibrator betoni	Pronësi ose me qira	2 copë
23.	Dedektor rrjetesh nentoksore me GPRS	Pronësi ose me qira	1 copë
24.	Betoniere kantieri 0.25 deri në 0.5 m3	Pronësi ose me qira	1 copë
25.	Autobetoniere kantieri me kapacitet mbajtes deri 2.5m3	Pronësi ose me qira	1 copë
26.	Paisje topografike Totalstation/GPS	Pronësi ose me qira	1 copë
27.	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronësi ose me qira	1 copë
28.	Rimorkiator per levizjen e makinerive te ndertimit me kapacitet mbajttese jo me pak se 20 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
29.	Semafore	Pronësi ose me qira	5 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

a) Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qira që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës ku të specifikohet dhe objekti, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij (aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes apo kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti).

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB për transportim e mjetëve (kodi III.2.B) (20 01 04, 20 02 06, 20 02 02) në Impiantin e Trajtit të Ujërave të Durrës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", "Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë" dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të

mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi,grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

Kjo licence është kerkuar per zerin e transportit te llumrave ne vendepozitimn e miratuar apo qe operatori ka akmarrveshje per depozitim.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata si mëposhtë:

- a.** Certifikatë: **ISO 9001/2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
- b.** Certifikatë: **ISO 45001 : 2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zërave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.2 germa “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të

ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta, mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i objektit prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekti prokurimi.

Shënim: Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qenë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha normat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standardeve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit DPS, në ato raste kur këto standarde janë unifikuar nga kjo Drejtori.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); dhe nenit 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), grupi i punës, i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor, hartoi Specifikimet Teknike për realizimin e objektit: " *Pastrim dhe Riparime të Sistemit të Kanalizimeve të Ujërave të Shiut* ", duke përcaktuar qartë kërkesat teknike, materialet, standardet dhe metodat e zbatimit që duhet të respektojë operatori ekonomik fitues, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme, sipas nenit 3 dhe nenit 36, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020.

Specifikimet Teknike janë hartuar bazuar në Metodën Standarde të Matjeve të Ndërtimeve Civile, dhe referojnë normat dhe standardet teknike në fuqi, duke garantuar cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e veprës, në funksion të natyrës dhe vlerës së kontratës.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit